



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK237/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI130/11

Parashtruesi

Z. Denić Mladen dhe z. Vitković-Denić Milorad

**Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI18/10, të 12 prillit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Denić D. Mladen dhe z. Vitković-Denić D. Milorad, me vendbanim në Kralëvë, Serbi, të përfaqësuar nga z. Vitković M. Branislav, avokat nga Kralëva, Serbia, të cilët i paraqitën kërkesën a parë (Rasti Nr. KI18/10) Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 24 shkurt 2010. Kërkesa ishte refuzuar si e papranueshme më 12 prill 2011.

Vendimi i kontestuar

2. Me kërkesën e tanishme, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të rishqyrtojë Aktvendimin për papranueshmëri të kësaj Gjykate në Rastin KI18/10, të po kësaj Gjykate, të datës 12 prill 2011, me të cilin Gjykata deklaroi të papranueshme kërkesën e parashtruesve të kërkesës për shkak se nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore. Aktvendimi iu ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 19 shtator 2011.

Objekti i çështjes

3. Me këtë kërkesës për rishqyrtimin e aktvendimit për papranueshmëri, parashtruesit e kërkesës ankohen se Gjykata nuk kishte marrë parasysh letrën e dorëzuar Gjykatës më 12 maj 2011.

Baza juridike

4. Rregulli 36 (3e) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 tetor 2011, parashtruesit i paraqitën kërkesën Gjykatës për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të kësaj Gjykate në rastin KI18/10, të datës 12 prill 2011, dhe i publikuar më 19 shtator 2011.
6. Më 18 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 130/11, emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 130/11, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.
7. Më 2 shkurt 2012, Gjykata kërkoj nga Gjykata Komunale në Prishtinë informata lidhur me statusin procedurës.
8. Më 29 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë u përgjigj se po shqyrtohej rasti i parashtruesve. Megjithatë, për shkak të kompleksitetit të rastit, numrit të madh të rasteve në pritje para gjykatës dhe vështirësive në komunikim me parashkruesit e kërkesës të cilët banojnë në Serbi, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk kishte pasur mundësinë të mbajë seancë.
9. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sa i përket rastit të mëhershëm të parashtruesve të kërkesës, rasti KI. Nr. 18/10, gjykuar më 12 prill 2011, kjo Gjykatë gjeti se kërkesa ishte e papranueshme në bazë të asaj se parashtruesit e kërkesës dështuan të dëshmojnë se i kishin shteruar të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligj, pasi që ata nuk kishin ngritur apo ndjekur shkeljet e pretenduara gjatë kohës kur procedurat ishin në pritje para Gjykatës Komunale apo para cilëso gjykatë të shkallës më të lartë. Ky vendim ishte publikuar më 19 shtator 2011.
11. Më 12 maj 2011, parashtruesit e kërkesës i kishin dorëzuar një letër kësaj Gjykate, duke pretenduar se neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës ishte shkelur, sepse deri më sot Gjykata Komunale në Prishtinë ende nuk kishte marrë ndonjë vendim lidhur me rastin e tyre, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Në kërkesën e parashtruesve për rishqyrtim, ata pretendojnë se kjo Gjykatë nuk ka marrë parasysh letrën të cilën parashtruesit e kërkesës ia kishin dorëzuar Gjykatës më 12 maj 2011, me të cilën parashtruesit kishin pretenduar se:

“ ...

a. Është shkelur neni 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës, sepse deri më sot Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me rastin e tyre, brenda një afati të arsyeshëm kohor;

b. Është shkelur neni 143.1 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës] i Kushtetutës, sepse Gjykata Supreme me Aktgjykimin e vet Nr. Cml.-Gzz. br. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007, nuk ka respektuar dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (Propozimi i Ahtisaarit), Aneksi VII, neni 2 para. 2.1 [Ndërmarrjet Shoqërore] dhe neni 3, para. 3.1 dhe 3.3 [Procesi i Shqyrtimit të Kërkesave në AKM], i cili parasheh se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës është kompetente për të vendosur për këtë çështje e jo Gjykata Supreme; dhe

c. Është shkelur neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] i Kushtetutës, sepse atyre nuk u ishte kthyer pasuria e vet.

...”

13. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3.e) të Rregullores së punës i cili parasheh:

“ ...

Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;

...”

14. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se sa i përket pretendimeve b) dhe c), ato janë po të njëjtat pretendime të bëra në kërkesën e parë. Kjo Gjykatë është marrë me këto pretendime në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI. 18/10, me të cilin është vendosur se parashtruesit e kërkesës nuk i kishin shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.
15. Prandaj, në bazë të rregullit 36(3) (e) të Rregullores së punës, Gjykata nuk mund të merret me to këtu.
16. Sa i përket pretendimit a), Gjykata vëren se është ankesë e re lidhur me zgjatjen e tepruar të procedurës e cila nuk bie brenda fushëveprimit të kërkesës së parë me të cilën është marrë kjo Gjykatë në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI. 18/10. Megjithatë, kjo nuk i ndalon parashtruesit e kërkesës të paraqesin kërkesë të re për t’u ankuar në zgjatjen e tepruar të procedurës.
17. Për më tepër, Gjykata vëren se për ankesën e parashtruesve të kërkesës, të cilën po e bëjnë tani para kësaj Gjykate lidhur me zgjatjen e tepruar të procedurës, nuk është vendosur ende nga Gjykata Komunale. Andaj, të gjitha argumentet lidhur me pretendimet e zgjatjes së tepruar të procedurës duhet paraqitur nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe nëse nuk janë të kënaqur, të ngrenë ankesë në gjykatat më të larta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme.
18. Nga kjo rrjedh se, në bazë të rregullit 36 (3.e) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme. Megjithatë, siç është cekur më parë, kjo nuk i parandalon parashtruesit e kërkesës nga parashtrimi i një kërkesë të re duke u ankuar për stërzgjatje të procedurës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të Rregullit 36 (3.e) të Rregullore së punës, më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI



- I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani